

Sexhdeja e Harresës



Muhamed es-Salih el-Uthejmin

SELEFI  **ORG**
Kurani dhe Suneti
sipas kuptimit të Selefëve të këtij Umeti



Hyrje

Me Emrin e Allahut, të Gjithëmëshirëshmit, Mëshirëplotit.

Lavdia i takon Allahut, Zotit të botëve. Lavdërimi dhe Bekimi i Allahut qofshin mbi Pejgamberin tonë, Muhamedin, i cili e përcolli Mesazhin e Qartë, si dhe mbi Familjen e tij, Shokët e tij dhe mbi të gjithë ata që e pasuan atë në mirësi, deri në ditën e Gjykimit.

E më pas:

Vërtet, shumë prej njerëzve nuk i dinë shumë prej gjykimeve të *sexhdes se harresës* në namaz. Kështu, disa prej tyre e lënë sexhden e harresës atëherë kur është obligim që të bëhet, disa të tjerë e bëjnë atë atëherë kur nuk duhet bërë, disa të tjerë e bëjnë sexhden e harresës përpara selamit, ndërkohë që duhej bërë pas selamit, disa të tjerë e bëjnë sexhden pas selamit, ndërkohë që duhet ta bënin para selamit...

Prandaj, është shumë e rëndësishme që të dihen *ahkamet* (dispozitat) e saj, e sidomos për imamët të cilët pasohen nga njerëzit dhe që kanë përgjegjësi për pasimin e asaj që është ligjruar për namazin e tyre dhe me të cilën i udhëheqin muslimanët në namaz ...

Kështu, pata dëshirën që t'u paraqes vëllezërve të mi disa prej dispozitave të këtij kapitulli, duke shpresuar se Allahu i Lartësuar do ta bëjë atë të dobishme për robërit e Tij besimtarë. Dhe them duke kërkuar ndihmën e Allahut të Lartësuar dhe duke kërkuar prej Tij sukses në atë që është e saktë:



Sexhdeja e harresës (suxhudus-sehu):

Sexhdeja e harresës përbëhet nga dy sexhde të cilat namazliu i kryen ato për të rregulluar gabimin që ka ndodhur në namazin e tij për shkak të harrësës. Dhe arsyet e saj janë tre:

1- Shtimi (në namaz)

2- Mangësimi

3- Dyshimi



1- Shtimi:

Nëse namazliu shton në namazin e tij një qëndrim në këmbë, një ulje, një ruku apo një sexhde, qëllimisht, namazi i tij bëhet i pavlefshëm; dhe nëse e bën nga harresa dhe nuk i kujtohet që ka shtuar në namaz, vetëm pasi e ka kryer atë, atëherë ai duhet të bëjë veçse sexhden e harresës dhe namazi i tij është i saktë. Dhe nëse i kujtohet shtimi gjatë kryerjes së saj, atëherë e ka detyrë që të kthehet mbrapa e të mos e vazhdojë më tej atë dhe e ka obligim sexhden e harresës dhe namazi i tij është i saktë.

Shembull:

Një njeri e fal namazin e drekës pesë rekate dhe nuk i kujtohet ky shtim vetëm se kur ai është në teshehud. Kështu, ai e plotëson teshehudin, jep selam dhe bën sexhden e harresës, pastaj jep selam.

Nëse i kujtohet shtimi që ka bërë vetëm pasi ka dhënë selam, atëherë bën sexhden e harresës dhe jep selam.

E nëse i kujtohet shtimi gjatë rekatit të pestë, ulet menjëherë për në teshehud (pra, nuk e vazhdon rekatit të pestë), jep selam, pastaj bën sexhden e harresës dhe jep selam.

Argument për këtë është hadithi i Abdullah Ibn Mes'udit (*radijAllahu anhu*)¹, se Pejgamberi (*sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem*), e fali namazin e drekës pesë rekate dhe i thanë: A shtove në namaz? Tha: “Çfarë shtova?” Thanë: Fale pesë rekate. Atëherë, ai bëri dy sexhde dhe pastaj dha selam. Dhe në një transmetim tjetër thuhet: I

¹ Mutefekun alejhi, e transmeton Bukhari, libri i namazit, kapitulli “ Ajo që ka ardhur rreth Kibles” (n.404) i shkurtuar dhe (n.401) i gjatë, në sexhden e harreses 1227 dhe në vende të tjera dhe i transmeton Muslimi në librin e Xhamive, kapitulli “Harresa në namaz” hidithi nr. 91, fq. 572.

përtheu këmbët duke u ulur mbi to, u drejtua nga kibla dhe bëri dy sexhde, pastaj dha selam. E transmeton këtë hadith xhemati (d.m.th. Bukhari, Muslimi, Ebu Davudi, Tirmidhiu, Nesaiu dhe Ibn Maxheh).²



² E ka transmetuar Ebu Davudi në Librin e Namazit, kapitulli, “Nëse fal pesë rekate” hadithi nr .2019 dhe hadithi 1020. Tirmidhiu në kapitullin “Ajo që ka ardhur rreth dy sexhdeve te harreses pas selamit dhe bërjes muhabet”, hadithi nr: 392. Nesaiu në Librin e Harresës, kapitulli “*et-Teharrij* - Ndenjtja në vend” 33/3, hadithi (n.1242) dhe (n.1243). Ibn Maxheh në Llibrin “ Kryerja e namazit”, kapitulli “ Ajo që ka ardhur rreth atij që dyshon në namazin e tij”, hadithi (n.1211).

Dhënia selam para se të plotësohet namazi:

Dhënia selam para se të plotësohet namazi, është shtim në namaz³. Pra, nëse namazliu jep selam **me qëllim**, përpara se ta plotësojë namazin e tij, namazi i tij bëhet i pavlefshëm.

Dhe nëse e bën nga harresa dhe i kujtohet vetëm pas një kohe të gjatë, e fal namazin sërish nga e para.

Dhe nëse kujtohet pas një kohe të shkurtër, si për shembull mbas dy apo tri minuta, atëherë ai e plotëson atë që ka lënë mangut nga namazi, jep selam, bën sexhden e harresës dhe jep selam.

Argument për këtë është hidithi i Ebi Hurejrës, *radijAllahu anhu*, që thotë se Pejgamberi *sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem*, fali me ta namazin e drekës apo të ikindisë, dha selam pasi fali dy rekate dhe doli me të shpejtë nga dyert e xhamisë. Ata thanë: “U shkurtua namazi.”. Më pas u ngrit Pejgamberi *sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem*, dhe u mbështet tek një dërrasë në xhami sikur të ishte i inatosur. Pastaj ngrihet një burrë dhe i thotë: “O i Dërguari i Allahut, a harrove apo e shkurtove namazin?” Thotë Pejgamberi *sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem*: “As kam harruar dhe as e shkurtova namazin”. Dhe burri thotë: Posi jo, paske harruar. Pastaj Pejgamberi, *sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem*, pyet sahabët: “A është e vërtetë ajo çka thotë?” Thanë: “Po.” Kështu, Pejgamberi *sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem*, bëri përpara dhe fali atë që kish ngelur mangët nga namazi, dha selam, bëri dy sexhde për harresën, pastaj dha selam. [Mutefekun alejhi]⁴

³ Aspekti i të qënit shtim, ngase shtoi një selam gjatë namazit të tij.

⁴ Transmeton Bukhari në Librin e Namazit, kapitulli “ Gërshetimi i gishtave në xhami dhe në në vende të tjera” (n.482) versioni i gjatë, dhe tek Libri i Ezanit, i shkurtuar (n.714) dhe 715. Dhe në Librin e Harresës (n.1226) dhe në vende të tjera e transmeton Muslimi në Librin e Xhamive, kapitulli “ Harresa në namaz”, hadithi (n.97, 573).

E nëse imami jep selam përpara se ta plotësojë namazin dhe ka nga ata që falen pas imamit që u ka humbur nje pjesë e namazit dhe ngrihen në rekatin tjetër që ta plotësojnë atë që kanë humbur, pastaj imami kujtohet se nuk e ka plotësuar namazin dhe ngrihet që ta plotësojë atë, atëherë ata që ishin ngritur më parë për të plotësuar namazin, zgjedhin: ose vazhdojnë të plotësojnë atë që kanë humbur nga namazi dhe më pas bëjnë sexhden e harresës, ose kthehen dhe ndjekin imamin dhe pasi ai jep selam, plotësohet ajo që u kish humbur prej namazit dhe bëjnë sexhden e harresës pasi që kanë dhënë selam. Dhe kjo është më e mirë dhe më e sigurtë.



2- Mangësimi:

a) - Mangësimi në arkanet (shtyllat) e namazit⁵:

Kur namazliu lë mangut një *ruk'n* (shtyllë) të namazit, nëse është tekbiri i ihramit (tekbiri fillestar me të cilin muslimani hyn në namaz), atëherë namazi i tij është i pavlefshëm, qoftë nëse e ka lënë me dashje apo padashje, sepse namazi i tij nuk ka filluar ende.

E nëse është diçka tjetër, përveç tekbirit fillestar, nëse e lë me dashje, namazi i tij bëhet i pavlefshëm.

E nëse e lë atë nga harresa, nëse mbërrin në të njëjtin vend të rekatit e tjetër (që ka lënë mangët në rekatit e parë), anulohet (pra, nuk quhet) rekati në të cilin kishte lënë mangët dhe ky rekati tjetër zëvendëson atë rekatit e mëparëshëm. E nëse nuk ka mbërritur akoma në vendin ku ka mangësuar, në rekatit e dytë (pra, është në rekatit tjetër por nuk ka arritur akoma në atë pjesën që e ka lënë mangët në rekatit e mëparëshëm), e ka obligim që të kthehet në atë *ruk'n* (shtyllë) që ka lënë, e kryen dhe vazhdon me të tjerat që vijnë pas tij dhe në të dy rastet e ka obligim që të bëjë sexhden e harresës pas selamit.

Shembull:

Një person e harron sexhden e dytë të rekatit të parë dhe i kujtohet kur ai është i ulur midis dy sexhdeve në rekatit të dytë; kështu, rekati i parë anulohet (pra, nuk quhet) dhe rekati i dytë është në

⁵ **Shënim i përkthyesit:** Arkanet (shtyllat) e namazit janë 14. Ato janë: 1- Nijeti, 2- Tekbiri fillestar (Thënia "Allahu Ekber" kur lidhesh në fillim të namazit), 3- Qëndrimi në këmbë (në namazet farz), 4- Këndimi i Fatihasë në çdo rekat, 5- Rukuja, 6- Ngritja nga rukuja, 7- Sexhdeja, 8- Ulja midis dy sexhdeve, 9- Qetësia gjatë kryerjes së secilës prej shtyllave të namazit, 10- Ulja në teshehudin e fundit, 11- Teshehudi i fundit, 12- Salavatet, pas teshehudit të fundit, 13- Selami, 14- Ruajtja e radhës së secilës prej shtyllave të namazit.

vend të të parit dhe tani ky rekat llogaritet rekat i parë dhe vazhdon namazin me pjesët e tjera të tij, jep selam, pastaj bën sexhden e harresës dhe jep selam.

Shembull tjetër:

Një person e harron sexhden e dytë dhe uljen që bëhet para se të biesh në sexhden e dytë në rekatit e parë dhe i kujtohet pasi që është ngritur nga rukuja e rikatit të dytë, në këtë rast kthehet mbrapa, ulet, bën sexhden, plotëson namazin e tij dhe jep selam, pastaj bën sexhden e harresës dhe jep selam.

b) - Mangësimi në uaxhibitet e namazit⁶:

Nëse namazliu lë ndonjë prej uaxhibateve të namazit, **me qëllim**, namazi i tij bëhet i pavlefshëm.

E nëse e lë nga harresa dhe kujtohet përpara se ta lërë atë pjesë të namazit ku ka lënë mangët, e kryen atë që ka lënë mangët dhe nuk ka asnjë obligim tjetër.

E nëse kujtohet pasi është larguar nga ajo pjesë e namazit që ka mangësuar, përpara se të mbërrijë në ruknin (shtyllën) që vjen pas tij, kthehet mbrapa, e kryen atë që ka lënë mangët dhe vazhdon më tej namazin, jep selam dhe pastaj bën sexhden e harresës dhe jep selam.

E nëse, kujtohet pasi që ka mbërritur në ruknin që vjen pas tij, bie obligueshmeria e kryerjes së tij dhe nuk kthehet mbrapa që ta kryejë,

⁶ **Shënim i përkthyesit:** Uaxhibitet e namazit janë tetë. Ato janë: 1- Tekbiri (thënia “*Allahu Ekber*”) kur kalon nga njëra pjesë e namazit në tjetrën, 2- Thënia “*Semi’ Allahu limen hamideh*”, 3- Thënia “*Rabbena ue lekel hamd*”, 4- Thënia “*Subhane Rabbij el-Adhijm*, në ruku”, 5- Thënia “*Subhane Rabbij el-E’ala*” në sexhde, 6- Thënia “*Rabbij-gfirlj*”, midis dy sexhdeve, 7- Teshehudi i parë, 8- Ulja në teshehudin e parë.

por vazhdon namazin dhe bën sexhden e harresës përpara se të japë salam.

Shembull:

Një person ngrihet prej sexhdes së dytë së rekatit të dytë, për në rekatit e tretë duke harruar që të ulet në teshehudin e parë dhe i kujtohet përpara se të ngrihet për në rekatit e tretë, në këtë rast ulet dhe e kryen teshehudin, pastaj plotëson namazin e tij dhe nuk ka asnjë obligim tjetër.

E nëse kujtohet pasiqë është ngritur përparara se të kryejë qëndrimin në këmbë, kthehet mbrapa, ulet në teshehud, pastaj e vazhdon atë që i ka ngeleur nga namazi, jep salam, pastaj bën sexhden e harresës dhe jep salam.

E nëse kujtohet pasi që ka qëndruar në këmbë, bie obligueshmëria e teshehudit dhe nuk kthehet mbrapa, por e vazhdon më tej namazin dhe bën sexhden e harresës përpara se të japë salam.

Argument për këtë është ajo që ka transmetuar Bukhari dhe të tjerët⁷ nga Abdullah bin Buhejnah, *radijAllahu anhu*, se Pejgamberi *sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem*, fali me ta namazin e drekës, fali dy rekatet e para dhe nuk u ul (domethënë nuk u ul në teshehudin e parë). Kështu, me të u ngritën edhe njerëzit (për në rekatit e tretë) derisa përfundoi namazin dhe njerëzit po prisnin që ai të jepte salam, pastaj ai tha *Allahu Ekber* ndërsa ishte i ulur dhe bëri dy sexhde përpara se të jepte salam, pastaj dha salam.



⁷ Transmeton Bukhari në Librin e Ezanit, kapitulli “ Kush nuk mendon se teshehudi është uaxhib”, (n.829) dhe në Librin e Harresës (n.1224, 1225) dhe në vende të tjera transmeton Muslimi në Librin e Xhamive, kapitulli “ Harresa në namaz”, hadithi (n.85, fq.570).

3- Dyshimi:

Dyshimi është mëdyshja se cila nga dy çështjet ka ndodhur.

Dhe dyshimi nuk merret në konsideratë në ibadete, në tre raste:

E para: Nëse është thjesht iluzion i cili nuk ka bazë, siç është vesvesi.

E dyta: Nëse i ndodh personit aq shpesh sa që nuk ka ibadet që ai të mos ketë dyshime.

E treta: Nëse ato të vijnë pasi që e ke përfunduar ibadetin, nuk u kushtohet rëndësi, për aq kohë sa nuk di gjë me siguri, kështu ai vepron me atë në të cilën është i sigurtë.

Shembull:

Një person fali namazin e drekës dhe kur e përfundoi namazin, dyshoi, a fali tre rekate apo katër. Në këtë rast, ai nuk i kushton rëndësi këtij dyshimi, përveç nëse bindet me siguri se ka falur tre rekate, e në këtë rast e plotëson atë që ka lënë mangët nga namazi – nëse nuk ka kaluar shumë kohë nga çasti që e ka mbaruar namazin – jep salam, bën sexhden e harresës dhe jep salam.

E nëse i kujtohet pasi që ka kaluar kohë e gjatë pasi që ka përfunduar namazin, atëherë e fal namazin e nga e para.

Ndërsa, dyshimi që vjen në raste në tjera, përveç këtyre të trejave që u përmendën, duhet të merret në konsideratë.

Dyshimi në namaz ndodh në njërin nga dy rastet:

I pari: Që personi të anojë më shumë tek njëra nga dy çështjet se ajo është e sakta sipas tij dhe vepron me të dhe e vazhdon namazin, jep salam, pastaj bën sexhden e harresës dhe jep salam.

Shembull:

Një person fal namazin e drekës dhe dyshon, a është rekati i dytë që po fal apo i treti? Pastaj bindet se është rekati i tretë. Kështu, e konsideron rekat të tretë dhe fal edhe një rekat tjetër pas tij dhe jep salam. Më pas, bën sexhden e harresës dhe jep salam.

Argument për këtë është ajo që është vërtetuar në dy Sahihët dhe në të tjerët, nga hadithi i Abdullah bin Mes'udit, *radijAllahu anhu*, se Pejgamberi *sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem*, ka thënë:

«إِذَا شَكَّ أَحَدُكُمْ فِي صَلَاتِهِ فَلْيَتَحَرَّ الصَّوَابَ فَلْيَتِمَّ عَلَيْهِ، ثُمَّ لِيَسْلَمْ، ثُمَّ لِيَسْجُدْ سَجْدَتَيْنِ»

“Nëse dikush prej jush ka dyshime në namaz, të mundohet të pasojë atë që është e saktë dhe vazhdon namazin në bazë të asaj që vërtetoi, pastaj të japë salam e të bëjë dy sexhde”. Këto janë fjalët që janë transmetuar tek Bukhari.⁸

E dyta: Kur personi nuk anon tek asnjëra nga dy çështjet se cila është e sakta, në këtë rast vepron atë që është e sigurtë dhe ajo është pakica (dmth se nuk e ka kryer atë pjesë të namazit), dhe në bazë të saj e vazhdon namazin, bën sexhden e harresës përpara se të japë salam, pastaj jep salam.

⁸ Transmeton Bukhari në Librin e Namazit, kapitulli “ Drejtimi kah Kibla”, 401 dhe Muslimi në Librin e Xhamive, kapitulli “ Harresa në namaz”, hadithi 89, fq 572.

Shembull:

Një person fal namazin e ikindisë dhe ka dyshim, a është rekati i dytë apo i tretë? Dhe nuk arrin në ndonjë përfundim të saktë a është e dyta apo e treta, në këtë rast ai e konsideron atë rekat të dytë, ulet për në teshehudin e parë, pastaj fal edhe dy rekate pas tij dhe më pas bën sexhden e harresës dhe jep selam.

Argument për këtë është ajo që transmeton Muslimi⁹ nga Ebi Seid el-Khudrij, *radijAllahu anhu*, se Pejgamberi *sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem*, ka thënë:

«إِذَا شَكَّ أَحَدُكُمْ فِي صَلَاتِهِ فَلَمْ يَدْرْ كَمْ صَلَّى ثَلَاثًا أَمْ أَرْبَعًا؟ فليطرح الشكَّ وليبني على ما استيقن ثم يسجد سجدتين قبل أن يسلم، فإن كان صلى خمساً شفعن له صلاته، وإن كان صلى إتماماً لأربع كانتا ترغيماً للشيطان»

“Nëse dikush prej jush ka dyshime në namaz dhe nuk e di sa ka falur, a ka falur tre rekate apo katër, atëherë e hedh tutje dyshimin dhe vepron me atë që është e sigurtë, pastaj bën dy sexhde përpara se të japë selam; nëse ka falur pesë rekate, atëherë ato (dy sexhdet e harresës) e bëjnë çift namazin e tij; e nëse ka falur tamam katër rekatet, ato (dy sexhdet) janë poshtërim për Shejtanin.”

Po ashtu shembuj të tjerë në rast dyshimi janë:

Një person vjen dhe e gjen imamin në ruku, bën tekbirin e ihramit (d.m.th. tekbirin fillestar) duke qëndruar drejt në këmbë, pastaj bie në ruku dhe në këtë moment kemi të bëjmë me tre raste:

⁹ Transmeton Muslimi në Librin e Xhamive, kapitulli i “Harresës në namaz”, hadithi 88, fq 571.

1- Ai është i sigurt që e ka kapur imamin në ruku përpara se të ngrihet prej saj, e kështu e ka kapur rekatin dhe bie obligueshmëria (nuk e ka obligim) e këndimit e *Fatihës*.

2- Ai është i sigurtë se imami është ngritur prej rukusë përpara se ai ta kapë imamin në të, kështu e ka humbur rekatin.

3- Të ketë dyshim, a e ka kapur imamin në ruku, dhe në këtë rast e ka kapur të gjithë rekatin, apo se imami u ngrit prej rukusë përpara se ai ta kapë atë dhe në këtë rast e ka humbur të gjithë rekatin. Nëse, anon tek njëra nga dy çështjet për të cilën kishte dyshim, atëherë vepron sipas asaj tek e cila anon ai, e kështu e plotëson namazin në bazë të asaj ku anon, jep selam dhe pastaj bën sexhden e harresës dhe jep selam, përveç në rast se nuk ka humbur gjë prej namazit, atëherë ai nuk e bën sexhden e harresës.

E nëse nuk anon tek asnjëra nga dy çështjet, atëherë vepron me atë që është e sigurtë (d.m.th. që e ka humbur rekatin) dhe në bazë të saj e plotëson më tej namazin e tij dhe bën sexhden e harresës përpara se të japë selam, e më pas jep selam.

Dobi:

Nëse dikush ka dyshim për namazin e tij, vepron me atë që është e sigurtë ose me atë tek e cila anon se është më e saktë sipas shtjellimit që u përmend. E nëse më pas i bëhet e qartë se ajo që veproi përputhet me realitetin dhe se ai as ka shtuar dhe as ka pakësuar në namazin e tij, atëherë bie për të obligueshmëria (nuk e ka obligim) e bërjes së sexhdes së harresës- sipas mendimit më të shquar të medh'hebit (Hanbelij) - për heqjen e asaj që e bën të obligueshëm sexhden e harresës - dhe që është dyshimi.

Dhe ka një mendim të dytë që thotë se nuk bie nga ai obligueshmëria e bërjes së sexhdes, me qëllim që të zemërohet shejtani, siç ka thënë Pejgamberi *sal-lAllahu ‘alejhi ue sellem*: “...e nëse ka falur tamam katër rekatet, ato (dy sexhdet) janë poshtërim për Shejtanin.” Dhe sepse ai kryeu një pjesë të namazit të tij për shkak të dyshimit gjatë kryejes së tij dhe ky është mendimi më i saktë.

Shembull:

Një person është duke e u falur dhe dyshon, a është rekati i dytë apo i tretë? Dhe ai nuk anon tek asnjëra nga këto dy çështje. Kështu, ai e konsideron se është rekati i dytë dhe në bazë të saj e plotëson më tej namazin e tij. Më pas, i bëhet e qartë se ai ishte rekati i dytë me të vërtetë. Në këtë rast ai nuk e ka obligim që të bëj sexhden e harresës sipas mendimit më të famshëm të medh’hebit (Hanbelij). Kurse sipas mendimit të dytë, të cilin e konsiderojmë si më të saktin, ai e ka obligim që ta bëjë sexhden e harresës përpara selamit.



Sexhdeja e harresës për atë që falet pas imamit:

Nëse imami harron në namaz, atij që falet pas imamit i bëhet obligim që ta pasojë imamin kur bën sexhden e harresës, sipas thënies së Pejgamberit *sal-lAllahu 'alejhi ue sellem*:

«إِنَّمَا جُعِلَ الْإِمَامَ لِيُؤْتَمَّ بِهِ، فَلَا تَخْتَلَفُوا عَلَيْهِ»

“Vërtet, imami është vendosur që të udhëhiqeni prej tij, prandaj mos e kundërshtoni atë...”

E deri tek thënia e tij:

«وَإِذَا سَجَدَ فَاسْجُدُوا»

“...e nëse bie në sexhde, bini edhe ju.” Transmetuar nga Bukhari dhe Muslimi nga hadithi i Ebi Hurejrës, *radijAllahu anhu*¹⁰.

Qoftë kur bën imami sexhden e harresës para selamit, qoftë kur e bën pas selamit, është obligim për atë që falet pas tij që ta pasojë atë, përveç se në rastin kur ai atij i ka humbur një pjesë e mirë nga namazi, në këtë rast nuk e pason imamin kur bën sexhden e harresës, sepse kjo është e pamundur për të e s’mund të japë selam njësoj me imamin, prandaj vazhdon ai të falë atë që i ka humbur prej namazit, jep selam e më pas bën sexhden e harresës dhe jep selam.

¹⁰ Transmeton Bukhari në Librin e Xhematit, kapitulli “Vërtet imami është vendosur që të udhëheqë”, (n.657); Muslimi në Librin e Namazit, kapitulli “Udhëheqja e atij që falet pas imamit nga imami”, (n.412); dhe shtesa “Nëse lexon dëgjoni me vëmendje” tek Ebi Davudi në Librin e Namazit, kapitulli “Imami falet...”, (n.604); Nesaiu në Librin e Hapjes, (n.920); Ibn Maxheh, 846 dhe Imam Ahmedi 420.

Shembull:

Një burrë hyn në namaz me imamin në rekatin e fundit, dhe imami duhet të bëjë sexhden e harresës pas selamit, atëherë kur imami të japë selam, ky burrë ngrihet për në rekatin tjetër për të kompesuar atë që i ka humbur nga namazi dhe nuk e bën sexhden e harresës bashkë me imamin. Dhe kur ta përfundojë atë që i ka humbur nga namazi dhe të japë selam, bën sexhden e harresës pas selamit.

E nëse harron në namaz ai që falet pas imamit dhe jo imami vetë, e nuk i ka humbur gjë prej namazit, atëherë ai nuk e ka obligim që të bëjë sexhden e harresës, sepse me këtë sexhde e kundërshton imamin dhe e mangëson pasimin që i bën atij dhe sepse Sahabët, *radijAllahu anhum*, e lanë teshehudin e parë kur Pejgamberi harroi të ulej në të dhe u ngritën bashkë me të (për në rekatin tjetër) dhe nuk u ulën në teshehud nga kujdesi i madh që kishin në pasim dhe në moskundërshtimin e tij.

E nëse ka humbur diçka prej namazit dhe harron kur është duke u falur pas imamit apo në atë që kompesoi pas imamit, nuk bie nga ai obligueshmëria e sexhdes. Kështu, ai bën sexhden e harresës pasi që të ketë përfunduar atë që humbi nga namazi, para selamit ose pas tij, në varësi të hollësirave të mësipërme.

Shembull:

Ai që falet pas imamit harroi të thoshte “**Subhane RabbijelAdhijm**” në ruku dhe nuk ka humbur gjë prej namazit, në këtë rast nuk e ka obligim bërjen e sexhdes së harresës.

E nëse i ka humbur një rekat apo më shumë, atëherë ai e kompeson atë, pastaj bën sexhden e harresës para selamit.

Shembull tjetër:

Ai që fal me imamin drekën dhe kur imami ngrihet për në rekatin e katërt, ai që falet pas imamit ulet me mendimin se është në rekatin e fundit, e kur e merr vesh se imami është ngritur, ngrihet. Nëse nuk ka humbur diçka prej namazit, nuk e ka obligim që ta bëjë sexhden e harresës. E nëse i ka humbur një rekat apo më shumë, atëherë e kompeson dhe jep salam, e më pas bën sexhden e harresës dhe jep salam. Dhe kjo sexhde ishte për shkak të uljes së tij shtesë gjatë kohës që imami u ngrit për në rekatin e katërt.



Përmbledhje:

Na u bë e qartë nga sa u përmend se sexhdeja e harresës bëhet herë para selamit, e herë pas selamit.

Bëhet para selamit në dy raste:

E para: Nëse ka ndodhur mangësim në namaz, për arsye se ka ardhur në hadithin e Abdullah bin Buhejnas, *radijAllahu anhu*, se Pejgamberi *sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem*, bëri sexhden e harresës para selamit në rastin kur la teshehudin e parë. U përmend më lartë hadithi fjalë për fjalë.

E dyta: Rastin kur kihet dyshim dhe nuk anon tek asnjëra nga dy çështjet se cila është e saktë, për arsye se ka ardhur në hadithin e Ebi Seid el-Khudriut, *radijAllahu anhu*, rreth atij që ka dyshime në namaz dhe nuk e di sa ka falur, a ka falur tre rekate apo katër, të cilin Pejgamberi *sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem* e urdhëroi që të bëjë dy sexhde përpara se të japë selam dhe u përmend më sipër hadithi fjalë për fjalë.

Sexhdeja e harresës bëhet pas selamit në dy raste:

E para: Në rastin kur shtohet në namaz, nga hadithi i Abdullahu ibn Mes'udit, *radijAllahu anhu*, kur Pejgamberi *sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem*, e fali drekën pesë rekate dhe e kujtuan atë pasi që kishte dhënë selam, kështu ai bëri dy sexhde, pastaj dha selam; dhe nuk sqaroi se sexhden e bëri pas selamit për shkak se nuk e dinte që kishte shtuar në namaz dhe e mori vesh vetëm pasi që kishte dhënë selam. Kështu, ky është argument i përgjithshëm se sexhdeja e harresës kur shton në namaz, bëhet pas selamit, qoftë kur e merr

vesh para selamit, qoftë kur e merr vesh pas selamit që ka shtuar në namaz.

E poashtu, në rastin kur jep selam nga harresa përpara se plotësojë të gjithë namazin, pastaj kujtohet dhe e plotëson atë. Pra, ai shtoi një selam gjatë namazit të tij, kështu që bën sexhden e harresës pas selamit, nga hadithi i Ebi Hurejrës, *radijAllahu anhu*, kur Pejgamberi *sal-lAllahu 'alejhi ue sellem*, dha selam në namazin e drekës apo të ikindisë pasi fali dy rekate, e më pas e kujtuan dhe e plotësoi namazin e tij, dha selam dhe më pas bëri sexhden e harresës dhe dha selam. U përmend më lartë hadithi fjalë për fjalë.

E dyta: Në rastin kur ka dyshim dhe anon tek njëra nga dy çështjet se ajo është më e sakta, nga hadithi i Ibn Mes'udit, *radijAllahu anhu*, se Pejgamberi *sal-lAllahu 'alejhi ue sellem*, e urdhëroi atë që dyshonte në namazin e tij, që të zgjedhë të saktën dhe në bazë të saj, të plotësonte namazin, të japë selam dhe të bëjë sexhden e harresës. U përmend më lartë hadithi fjalë për fjalë.

E nëse ndodhin dy harresa bashkë, vendi njëres prej së cilave është para selamit dhe tjetra pas selamit, kanë thënë Ulematë se: ka përparësi ajo para selamit, kështu që ai e bën sexhden para selamit.

Shembull:

Një person e fal namazin e drekës dhe ngrihet për në rekatin e tretë dhe nuk ulet për në teshehudin e parë, e ulet në teshehud në rekatin e tretë duke menduar se është rekati i dytë, pastaj i kujtohet se është rekati i tretë. Atëherë ngrihet dhe fal edhe një rekat, bën sexhden e harresës, pastaj jep selam.

Pra, ky person e la teshehudin e parë, sexhdeja e harresës e së cilës bëhet para selamit, pastaj shtoi një ulje në rekatin e tretë, sexhdeja e

harresës e së cilës bëhet pas selamit, kështu sexhdeja para selamit ka përparësi. Dhe Allahu e di më së miri.

Dhe e lus Allahun të na japë sukses neve dhe vëllezërve tanë Muslimanë në kuptimin e Librit të Tij dhe Sunetit të Pejgamberit *sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem*, dhe që të punojmë me to hapatazi dhe fshehtazi në akijde, ibadet, marrëdhënie me të tjerët dhe të na e zbukurojë fundin të gjithëve, vërtet Ai është më Bujari e Fisniku.

Lavdia i takon Allahut, Zotit të botëve, lavdërimi dhe bekimi i Allahut qofshin mbi Pejgamberin tonë, Muhamedin, mbi Familjen dhe mbi të gjithë Shokët e tij.

Shkroi:

¶ varfëri tek Allahu i Qartësuar,
Muhamed es-Salih el-Uthejmin
4/3/1400 Hixhrij



Përktheu: Umm ‘Akil